



Lajmet e Fundit: Himarë – Procedohen penalisht 4 shtetas, për veprën penale “Pushtimi i tokës”



Lajmet

24/07/2021

Shëngjin – Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 37-vjeçari

Shëngjin, Lezhë

Policia e Lezhës, kontrole të shtuara në të gjithë qarkun, për rritjen e parametrave të sigurisë gjatë sezonit turistik, për kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo me lëndë narkotike.

Si rezultat i kontrolleve është vënë në prangat një 37-vjeçar që qarkullonte me armë zjarri pistoletë në automjet.

Po gjatë kontrolleve, kapen dhe vihen në pranga 2 shtetas me precedent të mëparshëm kriminal në fushën e narkotikëve, armëmbajtjes pa leje, vjedhjes dhe krimeve kundër personit, të cilët posedonin fara narkotike të dyshuara canabis sativa.

Sekuestrohen armë zjarri pistoletë, municion luftarak, fara canabis, 3 celularë dhe 2 automjete.

Në zbatim të planit të masave për mbajtjen nën kontroll të situatës kriminale, kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo lëndë narkotike, bazuar dhe në informacionet e siguruar në rrugë operative për persona që qarkullojnë me armë zjarri në automjet, shërbimet e Policisë Lezhë dhe forca e posaçme “Shqiponja” ushtruan kontrole në disa automjete në Shëngjin, Lezhë e Milot.

Si rezultat, gjatë kontrollit të ushtruar në një mjet me drejtues shtetasin E.L., në çantën e tij, shërbimet e Policisë Lezhë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me një krehër me fishekë.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E.L., 37 vjeç, banues në Shkodër, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje” dhe materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, a për veprime të mëtejshme.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar nga forca e posaçme “Shqiponja”, në automjetin me drejtues shtetasin A.M. dhe pasagjer shtetasin A.G., u gjetën dhe sekuestruan një sasi farash të dyshuara narkotike cannabis sativa.

Këta shtetas dyshohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin siguronin farat e kanabisit për t’i shitur, me qëllim kultivimin e tyre.

Në vijim të veprimeve, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve A.M., 27 vjeç dhe A.G., 25 vjeç, banues në Lezhë, të dy me precedent të mëparshëm kriminal në fushën e narkotikëve, armëmbajtjes pa leje, vjedhjes dhe krimeve kundër personit.

Policia e Lezhës falënderon qytetarët për mbështetjen dhe besimin dhe i fton ata për të denoncuar në Komisariatin Dixhital dhe në numrin 112, çdo rast të paligjshmërisë, duke iu siguruar anonimatin të plotë dhe reagim të menjëhershëm e të paanshëm nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)



Share



Share



Share



Share



Email

◀ Fier – Finalizohet operacioni “Kalldrëmi”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Korçë – Qarkullonte me armë zjarri në automjet, vihet në pranga 32-vjeçari ▶